

This Edition of E-Newsletter is available only in Albanian language. Ky edicion i E-news është vetëm në Gjuhën Shqipe.

Duke punuar të gjithë së bashku në mund të ndërtojmë një botë më të mirë për femijet!

"NDIHMONI FEMIJET"

Gazete Elektronike e Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve
ne Shqiperi - CRCA

Financuar nga: Olof Palme International Center and SIDA, Suedi

Edicioni 372
i Pare - 19/05/1999

08/06/2007

Edicioni

NE KETE EDICION:

- CRCA: 12 QERSHOR, MANIFESTIM KUNDER PUNES DHE SHFRYTEZIMIT TE FEMIJEVE NE SHQIPERI
 - KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT HAP KLINIKEN LIGJORE FALAS
 - FONDACIONI MJAFT: NISME E RE NE NDIHME TE TE RINJVE SHQIPTARE "UDHETIM NE EUROPE"
 - CLCI: HYN NE FUQI LIGJI KUNDER DHUNES NE FAMILJE (Deklarate per Shtyp)
-

CRCA: 12 QERSHOR, MANIFESTIM KUNDER PUNES DHE SHFRYTEZIMIT TE FEMIJEVE NE SHQIPERI

12 QERSHOR - 12 MESAZHE - 12 PERSONALITETE TE SHOQERISE CIVILE

ora 11.00, perpara Ministrise se Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta

12 Qershori ne te gjithë Boten eshte nje dite ku shoqeria civile, sindikatat e punetoreve dhe mediat, protestojne ose angazhohen ne veprime sensibilizimi dhe avokatesie kunder punes dhe shfrytezimit te femijeve. Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne Shqiperi - CRCA qe nga viti 1999 ka protestuar ne nje sere qytetesh te Shqiperise, se bashku me femijet, per t'i thene NDAL PUNES DHE SHFRYTEZIMIT TE FEMIJEVE.

CRCA ne bashkepunim me Koalicionin Kunder Trafikimit dhe Shfrytezimit Seksual te Femijeve (ACTSEC) edhe kete vit, ka marre iniciativen qe ne daten 12 Qershor 2007 - Diten Nderkombetare Kunder Punes dhe Shfrytezimit te Femijeve, te bashkoje zerin dhe forcat e shoqerise civile ne organizimin e nje manifestimi nepermjet se cilet do te kerkohet nga Qeveria shqiptare dhe Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta te marrin masa kunder punes dhe shfrytezimit te femijeve ne Shqiperi.

Ne kete manifestim ne kemi ftuar 12 personalitete nga te gjitha fushat e jetes se shoqerise civile per te dhene 12 mesazhe ne mbrojtje te femijeve qe punojne si dhe per te ndergjegjesuar opinionin publik shqiptar per kete fenomen negativ qe ka perfshire me dhjetra-mije femije ne te gjithë Shqiperine.

Ne 12 Qershor, ne ora 11.00, perpara Ministrise se Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, ne do te manifestojme se bashku per t'i thene: "Ndal Punes dhe Shfrytezimit te Femijeve". CRCA ka ftuar 12 personalitete te shoqerise civile te japin 12 mesazhe ne kete dite:

1. CRCA - Deklarata e Shoqerise Civile "Ndal Punes dhe Shfrytezimit te Femijeve ne Shqiperi"
2. Znj. Kozara Kati - Qendra Shqiptare per te Drejtat e Njeriut
3. Znj. Vasilika Hysi - Komiteti Shqiptar i Helsinkit
4. Z. Skender Veliu - Unioni i Romeve "Amaro Drom"
5. Z. Genci Terpo - Grupi Shqiptar per te Drejtat e Njeriut
6. Znj. Hajrie Hasanaj - Shoqata ne Ndhime te Femijeve Jetime
7. Z. Adrian Kati - Qendra Shqiptare per Rehabilitimin e Viktimave te Tortures
8. Znj. Vera Lesko - Qendra "Vatra" Vlore
9. Znj. Ingrid Trajani - Shtepia e Kuqe (Ne ndihme te Femijeve me Aftesi te Kufizuar)
10. Znj. Olimbi Hoxhaj - Shoqata e Personave qe Jetojne me HIV/AIDS ne Shqiperi
11. Z. Arbi Mazniku - Levizja MJAFT
12. Znj. Julinda Gjika - Parlamenti Rinor

Ne emer te CRCA kemi kenaqesine qe t'ju ftojme ju dhe organizaten tuaj te beheni pjese e ketij manifestimi ne mbrojtje te femijeve qe punojne dhe femijeve te shfrytezuar. Ejani edhe ju te thoni mesazhin tuaj kunder punes dhe shfrytezimit te femijeve ne Shqiperi.

Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne Shqiperi - CRCA

Adresa postare: Kutia Postare 1738, Tirana / ALBANIA

Tel / Fax: + 355 4 242264

E-mail: crca@crca.org.al

www.crca.org.al

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT HAP KLINIKEN LIGJORE FALAS

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është një organizatë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e cila është themeluar në 19 dhjetor të vitit 1990 si “Forumi për Mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut”. Në 22 Mars 1992, organizata u anëtarësua në Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, duke marrë dhe emrin që ka sot.

KShH ka si pjesë të misionit të tij mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe rivendosjen e tyre në rastet e shkeljeve të ndryshme. Kjo realizohet nëpërmjet reagimeve publike, letrave drejtuar autoriteteve shtetërore, verifikimeve në vend, këshillimeve ligjore, etj.,

Sipas vëzhgimeve të organizatave të të drejtave të njeriut, mes tyre edhe KShH, shërbimi avokator falas në Shqipëri lë për të dëshiruar si në cilësi ashtu dhe në shtrirjen e shërbimeve që ofrohen. Nisur nga kjo e fundit dhe nga kërkesat e adresuara nga qytetarët, KShH ndërmori një iniciativë të re, **hapjen e një Klinike Ligjore për ofrimin e shërbimit avokator falas** në fushën penale, kryesisht për njerëzit në nevojë dhe që nuk kanë mundësi financiare për të përballuar vetë shpenzimet e avokatit, falë kjo mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit.

Objektivi kryesor i këtij shërbimi është forcimi i shtetit ligjor nëpërmjet mbrojtjes më të mirë të grupeve vulnerabël, të drejtat e të cilëve shkelen nga përfaqësuesit të institucioneve shtetërore.

Kush mund të drejtohet KShH-së?

- Personat të cilët janë viktimë të ushtrimit të dhunës, trajtimeve dhe degradimeve njerëzore, nga organet e policisë, personelin e vendeve të paraburgimit dhe burgjeve;
- Personat të cilët janë viktimë të diskriminimit nga punonjësit të institucioneve shtetërore në përgjithësi (përfshirë dhe romët & egjiptianet).
- Çnimi i të drejtave të shtetasve si pasojë të një procesi jo të rregullt ligjor.

Llojet e shërbimeve të ofruara nga KShH

Shërbimi i ri i ofruar nga KShH do të përfshijë **Trajtimin, verifikimin dhe këshillimin ligjor** të ankesave të adresuara në KShH.

Risia që KShH do të sjellë përfshin **asistencën ligjore** që u ofrohet qytetarëve për **plotësimin e dokumentacionit për në gjykatë, adresimin e ankesave në institucionet shtetërore kompetente**, si dhe në raste të veçanta të shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut **Përfaqësimin e shtjeteve në gjykatë**.

Në këtë Klinikë ligjore do të angazhohen avokatë të kualifikuar të cilët do t’u ofrojnë qytetarëve shqiptarë jo vetëm seriozitet, cilësi, por dhe konfidencialitet.

Për herë të parë në Shqipëri ofrohet një shërbim avokator i ri falas për rastet kur përfaqësues të institucioneve shtetërore kanë ushtruar dhunë, torturë dhe trajtime të tjera njerëzore, kur kanë

diskriminuar si dhe kur kanë shkelur të drejtat e personit për një proces të rregullt gjyqësor.

Shtrirja gjeografike e kësaj shërbimi:

Shërbimi ligjor falas do të jetë i fokusuar në Tiranë, por nuk do të mungojnë dhe në disa rrethe ku veprojnë korrespondentët e KShH-së, konkretisht në Korçë, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Fier, Gjirokastër.

Mënyrat e marrjes së ankesave dhe kërkesave për përfaqësim:

- Nëpërmjet linjes telefonike
- Nëpërmjet takimeve në zyrë
- Letrave drejtuar në adresën e KShH-së

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Kutia Postare 1752, Tirane

Tel/Fax: 04 233671

Cel: 0355 68 20 23699

E-mail: office@ahc.org.al

www.ahc.org.al

FONDACIONI MJAFT: NISME E RE NE NDIHME TE TE RINJVE SHQIPTARE "UDHETIM NE EUROPE"

Fondacioni MJAFT!, në bashkëpunim me Institutin AGENDA, Lëvizjen Europiane në Shqipëri si dhe Ambasadorin Gjermanë, hap konkursin për projektin "UDHËTIM NË EVROPË", për studentët shqiptarë të cilët janë në vitin e tyre të fundit ose të parafundit akademik.

Përbajtja e projektit "UDHËTIM NË EVROPË" është e thjeshtë. Vetë koncepti kryesor e bën këtë projekt tërheqës për grup-moshat e reja.

Thelbi i projektit qëndron në sigurimin e mundësisë së udhëtimit të lirë në Evropë për 30 - 50 studentët më të mirë të universiteteve të Shqipërisë. Kështu studentët do të pajisen me vizë Shengen dhe biletë treni transevropiane të vlefshme për një muaj gjatë verës së vitit 2007. Udhëtimi do të jetë i lirë dhe secili nga studentët do të ketë mundësinë të ndërtojë itinerarin personal të udhëtimit.

Për tu njohur me kriteret për kandidatët, si dhe dokumentacionin shoqëruar jeni të lutur të vizitoni faqen e internetit: www.euroudhetim.org. Tek kjo faqe mund të shkarkoni formularin e aplikimit si dhe mund të gjeni një informacion më të gjerë mbi këtë nisim.

Data e fundit e dorëzimit të të gjithë dokumentacionit është data 20 Qershor, 2007.

Fondacioni MJAFT

Adresa: Rruga e Elbasanit, nr. 71, Tirana, Albania

Tel/Fax: +355 (0) 4 235 634

Cel: +355 (0) 68 27 10000

CLCI: HYN NE FUQI LIGJI KUNDER DHUNES NE FAMILJE (Deklarate per Shtyp)

Më 1 Qershor, në ditën ndërkombëtare të familjeve, hyri në fuqi ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili u miratua nga Kuvendi në dhjetor të vitit 2006. Ai ishte rezultat i nismës qytetare dhe u propozua në Kuvend nga 20 mijë zgjedhës, duke u bërë kështu, një nga hapat më të sigurt për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare në fushën e legjislacionit kundër dhunës në familje.

Ligji synon të parandalojë dhe minimizojë dhunën në familje e të garantojë mbrojtje për të gjithë anëtarët e saj, duke i kushtuar vëmendje të veçantë veçanërisht, familjeve. Kjo mbrojtje u ofrohet të gjitha subjekteve të dhunuara, pavarësisht nga gjinia e tyre, si dhe pavarësisht nga fakti nëse kanë qenë apo janë në marrëdhënie familjare. Për këtë, ligji ngarkon me detyrë të posaçme organet e administratës shtetërore, të cilat marrin të gjitha masat e nevojshme, për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e familjarëve.

Organizatat jofitimprurëse, nismëtare të këtij ligji, po ndjekin me shqetësim faktin se ky 1 Qershor, e gjen përsëri shoqërinë shqiptare të tronditur nga dhuna në familje. Ndërkohë, veprimet e ndërmarra nga aktorët që kanë detyrë për zbatimin e këtij ligji, janë të ngadalta dhe të pamjaftueshme.

Aktualisht, ka nevojë për veprime urgjente, veçanërisht, në miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit, pra deri më 1 Shtator të këtij viti. Gjithashtu, ligji kërkon koordinimin më të mirë të veprimeve të rrjetit të organeve administrative shtetërore, të përbeura nga Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe të drejtuar nga Ministria e Punëve, të shtjeteve sociale dhe shanseve të barabarta, përfshirë edhe strukturat në varësi të tyre, si komisaritet e policisë urgjencat mjekësore, shërbimet avokatore falas dhe ato përmbartimore.

Rëndësi të veçantë, paraqet koordinimi i veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror me organet e njësive të qeverisjes vendore, bashkive e komunave, të cilat janë përgjegjëse të drejtpërdrejta për shërbimin social dhe linjën telefonike 24-orëshe për denoncimin e rasteve të dhunës në familje. Detyrimet e këtij ligji nuk mund të përmbushen nëse nuk vendosen lidhje të qëndrueshme institucionale dhe ura të bashkëpunimit midis organeve shtetërore të rrjetit dhe organizatave jofitimprurëse, për krijimin dhe licencimin e të gjitha qendrave, që në bazë të ligjit do të ofrojnë ndihmën sociale, psikologjike e ligjore për personat e dhunuar në familje, si dhe për rehabilitimin e dhunuesve/seve.

Nga ana jonë, ne organizatat jofitimprurëse jemi të ndërgjegjshëm për punën që duhet të kryejmë, për të funksionuar me efektivitet në përmbushjen e detyrimeve që ligji parashtron për ne, por për këtë, kërkojmë edhe ndihmën nga organet kompetente shtetërore.

Gjykatat janë përgatitur tashmë për të zbatuar këtë ligj, me qëllim dhënien e urdhrave civilë të

mbrojtjes, por është e rëndësishme që qytetarët ta njohin mirë ligjin, të ndërgjegjësohen dhe të kërkojnë mbrojtjen e tyre në bazë të dispozitave të tij. Mendojmë se kjo nuk mund të realizohet pa krijuar trupën e avokatëve që do të ofrojnë ndihmën ligjore falas, si dhe licencimin e mbështetjen e të gjitha qendrave që do të ofrojnë shërbime në bazë të këtij ligji.

Në përfundim, shprehim bindjen tonë të thellë se, të gjithë aktorët, do të japim kontributin e tyre për zbatimin me sukses të këtij ligji dhe puna do të vazhdojë më tej, e gërrshetuar edhe me faktorët e tjerë, për të minimizuar fenomenin antinjëzor si është dhuna në familje.

Deklarata mbështetet nga:

QENDRA PËR NISMA LIGJORE QYTETARE, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Aleanca Gjinore për Zhvillim, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Strehëza për Gra dhe Vajza, Linja e Ndihmës për Familjet – Tiranë, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Familjeve në Shqipëri, Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Familjeve në Shqipëri, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin, Shoqata “Në Dobi të Gruas Shqiptare”, Koalicioni për Nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave, të Rinjve dhe Minoriteteve në Politike, Koalicioni kundër Trafikimit dhe Shfrytëzimit Seksual të Familjeve në Shqipëri

Për do pyetje, mos hezitoni të kontaktoni:

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Adresa: Rr. “Vaso Pasha”, Pall. 12, Shk.1, Ap.1, Tirane

Tel. 04 259795

E-mail: avokatore@albmail.com

www.qag-al.org

RRETH GAZETES ELEKTRONIKE

Kjo Gazete Elektronike përgatitet nga Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Femijëve në Shqipëri - IRCCRA për llogari të Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri - CRCA.

Mese 400 organizata dhe institucione në Shqipëri, në Europë, si dhe partnere të CRCA / IRCCRA janë të abonuar ose marrin një kopje elektronike të kësaj gazete. Nëse dëshironi që të botoni lajmet, raportet, njoftimet, ftesat apo dokumnta të tjere të zyres suaj, që kanë lidhje me femijet ose me të drejtat e njeriut, ju lutem kontaktoni me IRCCRA.

Nëse dëshironi që të abonoheni ose refuzoni këte gazete elektronike ju lutem dergoni një e-mail në: ircra@crca.org.al

Kjo Gazete Elektronike përgatitet nga Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e

Femijeve ne Shqiperi - IRCCRA.

Te gjithë lexuesit janë te lejuar dhe te inkurajuar qe te kopjojne dhe shperndajne te gjithen ose pjese te ketij botimi elektronik, por gjithmone duke i dhene atributet kryesore Qendres se Informacionit dhe Kerkimeve per te Drejtat e Femijeve ne Shqiperi - IRCCRA. Asnje pjese e ketij botimi elektronik nuk mund te shitet.

Opinionet e shprehura ne kete E-newsletter jo domosdoshmerisht shprehin opinionet e CRCA / IRCCRA, ose ato te Olof Palme International Center ose SIDA.

Qendra e Informacionit dhe Kerkimeve per te Drejtat e Femijeve ne Shqiperi - IRCCRA

Adresa: Kutia Postare 1403, Tirane / Shqiperi

Tel / Fax: ++ 355 4 24 22 64

E-mail: irccra@crca.org.al

www.crca.org.al
